



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 351/5 prot.

Tiranë, më 22.04.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 46, datë 22.04.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË
ADMINISTRIMIT TË MARRËDHËNIES SË PUNËSIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR NËPUNËSEN A. MUHAMETAJ, NË INSTITUCIONIN E BASHKISË
ELBASAN DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË
RREGULLUAR PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, për nëpunësen Ariola Muhametaj, me detyrë “Drejtore”, në Drejtorinë e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban, në Bashkinë Elbasan,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nëpërmjet shkresave të regjistruara me nr.351 prot., datë 23.02.2026 dhe nr. 351/1 prot., datë 02.03.2026, të dërguara nga nëpunësja Ariola Muhametaj, me detyrë “Drejtore”, në Drejtorinë e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban, në Bashkinë Elbasan, është njohur me përmbajtjen e tyre, në të cilat ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, si dhe transferimit në shërbimin civil.

Në këto kushte, nëpunësja A. Muhametaj ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga subjekte të ligjit, gjatë administrimit të shërbimit civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja A. Muhametaj, filloi procesin e verifikimit të informacionit dhe nëpërmjet shkresës nr. 351/2 prot., datë 06.03.2026, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje verifikimin e informacioneve të dërguara pranë Komisionerit me shkresat nr. 351 prot., datë 23.02.2026 dhe nr. 351/1 prot., datë 02.03.2026, nga nëpunësja Ariola Muhametaj*”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të procedurave të ndjekura në këtë rast, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin janë materializuar ato.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Elbasan, me shkresën nr. 1280/1 prot., datë 18.03.2026, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, e protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 351/3 prot., datë 24.03.2026, ka dërguar dokumentacionin ku materializohen veprimet e kryera nga organet e ngarkuara nga ligji gjatë administrimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, për nëpunësen Ariola Muhametaj, me detyrë “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban, në Bashkinë Elbasan.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, me vendimin e emërimit nr. 719 prot., datë 31.08.2020, të titullarit të institucionit, nëpunësja Ariola Muhametaj, është emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Prokurimeve Publike, në Bashkinë Elbasan.

Më pas, me urdhrin nr. 570, (nr. 2311 prot.), datë 09.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë, nëpunësja është emëruar përkohësisht në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, (*pozicioni ka ndryshuar emërtesë “Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban*).

Në kuadrin e vlerësimit të ligjshmërisë së procedurave të ndjekura në rastin e nëpunëses A. Muhametaj, evidentohet se janë kryer veprimet si më poshtë:

1. *Përsa i përket procedurës disiplinore të ndjekur, nga dokumentacioni i administruar rezulton se, nëpunësja ka qenë me raport leje lindje për periudhën 12.01.2025-08.12.2026, (dërguar për efekt prove nga nëpunësja A. Muhametaj, me foto, raportet e mjekut lëshuar me nr. regjistri 1415236, nga “American Hospital 3”, për periudhën 12.01.2025- 16.03.2025 dhe me nr. 2836, të Qendrës Shëndetësore nr. 4, Elbasan, për periudhën 11.11.2025- 08.12.2025).*

Pas përfundimit të lejes së lindjes, nëpunësja ka kryer edhe lejen vjetore të prapambetur për vitet 2023 dhe 2024, dhe në datën 09.02.2026 është rikthyer në punë.

Në momentin e rikthimit, nëpunësja i është drejtuar njësisë së burimeve njerëzore, pranë Bashkisë Elbasan, duke kërkuar një vërtetim, nëse ka masë disiplinore në ngarkim të saj. Më tej, njësia e burimeve njerëzore, me anë të shkresës nr. 705 prot., datë 11.02.2026, ka vënë në dijeni nëpunësen në fjalë, se ndaj saj është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, me urdhrin nr. 762, (nr.4754 prot.), datë 22.09.2025, të Kryetarit të Bashkisë, me motivacionin: “Për shkak të shkeljeve të konstatuara nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së”.

Sa i takon ligjshmërisë së dhënies së kësaj mase disiplinore, vlerësojmë se duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Konkretisht, në nenin 57, “Përgjegjësia për masat disiplinore”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

- a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohen “Llojet e masave disiplinore” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

- a) vërejtje;*
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;*
- c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.*
- ç) largim nga shërbimi civil”,*

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në germat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “Organet Disiplinore”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë: njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, parashikohet në VKM-në nr.115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, i ndryshuar, si edhe në mënyrë më të detajuar për secilën fazë të saj, në Udhëzimin nr. 1, datë 21.01.2025, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet për analogji, në rastin e institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

Në mbështetje të dokumentacionit të administruar për hetimin e këtij rasti, sa i takon aspektit procedural të ecurisë, konstatohet se, **nuk janë respektuar** kërkesat e parashikuara në pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, **pasi nuk është paraqitur asnjë dokument shkresor** që të pasqyrojë veprimet administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses, nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore; vlerësimit të shkeljes së pretenduar; vënies në dijeni me shkrim të nëpunëses; deri në marrjen e vendimit përfundimtar për dhënien e masës disiplinore, *“Vërejtje”*. Në këtë rast, i gjithë procesi është finalizuar me urdhrin nr. 762, (nr. 4754 prot.), datë 22.09.2025, të titullarit, për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje”*, në ngarkim të nëpunëses Ariola Muhametaj.

Sa më lart, konstatohet se, urdhri nr. 762, (nr.4754 prot.), datë 22.09.2025, për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje”*, i nxjerrë nga titullari i institucionit, në zbatim të germës a), ii), të nenit 108 *“Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Më tej, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, parashikohet se, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, e në këto kushte, vetë organi publik, që në këtë rast përkon me

titullarin e institucionit, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 762, datë 22.09.2025, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses Ariola Muhametaj, si dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e dhënies së masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses.

2. Sa i takon transferimit të nëpunëses nga pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban, në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit, vlerësimi i së cilës është një aspekt tjetër i hetimit administrativ, rezulton se:

Me aktin nr. 139, (nr. 843 prot.), datë 18.02.2026, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, nëpunësja është transferuar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit. Referuar pjesës hyrëse të aktit, konstatohet se, megjithëse emërtohet “Për transferim në detyrë”, në të, nuk janë përcaktuar si bazë ligjore dispozitat e kreut VIII, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm, të nëpunësve civil”, që rregullojnë të gjitha rastet e transferimit të nëpunësit civil.

Në këto kushte, rezulton se nëpunësja në të dyja rastet është transferuar në pozicionet të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, në kundërshtim me kërkesat e të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe si dhe Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, dispozita në të cilat rregullohet instituti i transferimit në shërbimin civil.

Për këtë arsye bazuar në nenin 109, germa b) dhe c), të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, nëpunësja A. Muhametaj duhet të rikthehet në pozicionin e punës ku ka emërimin e rregullt në shërbimin civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të neneve 108 deri 111 dhe 114, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Bashkisë Elbasan, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Kryetari i Bashkisë Elbasan, në zbatim të 108, germës a), pika ii, nenit 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 762, datë 22.09.2025, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses Ariola Muhametaj dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses dhe nga Regjistri Qëndror i Personelit.
2. Gjithashtu, në zbatim të nenit 109, gjerat b) dhe c) dhe nenit 114, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Kryetari i Bashkisë, duhet të anulojë urdhrin nr. 139, datë 18.02.2026, “Për transferim në detyrë”, si dhe të urdhërojë rikthimin e nëpunëses Ariola Muhametaj, në pozicionin ku ka emërimin e rregullt në shërbimin civil.
3. Njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Bashkisë Elbasan, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Elbasan, si dhe nëpunësja Ariola Muhametaj.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERE

Lefterije Lleshi (Luzi)